



Ndërtesa e Elektrokovës
Bulevardi Bill Klinton nr.5
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

*Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.5
Prishtina 10000
Republic of Kosovo*



KODI I PUNËS PËR QASJE NË TOKË DHE NDËRTESA

**Prishtinë,
16 Nëntor 2022**



PËRMBAJTJA

1	Hyrje	3
2	Definicionet	5
3.	Kushtet e Përgjithshme	7
4.	Kushtet e veçanta	8
6	Pëlqimet dhe Servitutet	10
7	Krijimi dhe regjistrimi i Servitutit të Rrjetit	10
8	Kushtet e marrëveshjes për servitut	11
9	Rrjeti i ndërtuar në periudhën kohore 1990 - qershor 1999	11
10	Qasja në lokacionet në pronësi ose të operuara nga pronari	12
11	Qasja në pjesët tjera të instalimeve të përdoruesve të sistemit	12
12	Përdorimi i gjuhëve.....	12
13	Procedura e kontesteve	13
14	Kompensimi i dëmeve	13
15	Mbrojtja e servituteve	13
16	Rrethanat e paparashikuara	13
17	Ndikimi i forcës madhore	14
18	Ndryshimi	14
19	Hyrja në fuqi	14



1 Hyrje

- 1.1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet OSSh-ja ka nevojë të qasjes në tokë/ose ndërtesa të palëve të treta ku kërkohet vetëm për kryerjen e aktiviteteve të tij të licencuara . Të drejtat dhe obligimet e OSSh-së për qasjes në tokë/ose ndërtesa të palëve të treta përcaktohen në Ligjin 05/L-81 për Energjinë – Kapitulli VIII, Nenin 18 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhënë KEDS-it, Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, në marrëveshjet për servitute dhe në marrëveshjet për kyçje.
- 1.2. Ky Kod përcakton detyrat dhe përgjegjësit e punonjëseve të autorizuar të KEDS-it apo kontraktuesit e autorizuar të cilët kryejnë shërbime në emër dhe për llogari të OSSh-së, do të qasen në tokë apo ndërtesa, kur është e nevojshme të ndërmerren veprime në procesin normal dhe emergjent të punës së OSSh-së. OSSh-ja i ushtron të drejtat e saja të definuara me licencë dhe pa i deleguar te personat tjerë juridik ose fizik.
- 1.3. Personat fizikë ose juridik do t'iu lejojnë përfaqësuesve të autorizuar të ndërmarrjeve të energjisë (OSSh-së) qasje në pronën e tyre në të cilën gjenden stabilimentet, aparaturat, rrjetet, ose sistemet energjetike në të cilat qasja e tillë është e nevojshme, me qëllim të mirëmbajtjes apo kontrollimit të tyre, prerjes së pemëve ose vegjetacionit tjetër që mund të pengoj veprimin e stabilimenteve, aparaturës, rrjeteve ose sistemit.
- 1.4. Punonjësit e OSSh-së, kanë të drejtë të qasen në pronën private me kusht që të jenë në detyrë zyrtare në OSSh. Punonjësit e OSSh-së kur e shfrytëzojnë këtë të drejtë duhet të veprojnë me kujdesin maksimal të një nikoqiri të mirë, duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për një mbarëvajtje të punëve zyrtare. OSSh-ja duhet të krijojë marrëdhënie korrekte me pronarët e tokave private dhe pronarëve të ndërtesave duke njoftuar me shkrim dhe duke dëshmuar me autorizim pronarin për qëllimin e hyrjes në tokë dhe ndërtesa dhe duke u identifikuar punëtorët ose kontraktuesit para se të hyjnë në pronën private. Një kopje të Autorizimit dhe punëtorëve duhet ti jepet pronarit të tokës apo ndërtesave si dëshmi për punët që do kryhen.
- 1.5. Me krijimin e rrethanave të caktuara, OSSH mund të vihet në atë pozitë që të mos ketë mundësi t'i përmbush kërkesat e këtij Kodi. OSSH do të jetë e obliguar të hulumtojë dhe të gjejë zgjidhje tjera të cilat do të garantonin siguri në furnizim, qoftë ky edhe veprim i njëanshëm i OSSH-së. Kjo zgjidhje alternative nuk duhet të trajtohet/kuptohet si ndryshim i rregullave të këtij Kodi. Për të mos pasur keqkuptime të tilla ky proces duhet të përcillet/apo të involvohet nga palët e përfshira dhe të interesuara
- 1.6. Personat fizikë dhe juridikë duhet t'iu lejojnë qasje përfaqësuesve të autorizuar të ndërmarrjeve të energjisë, për inspektimin e pajisjeve për matje që gjenden në pronën e tyre, në të cilën qasja e tillë është e nevojshme, dhe nuk mund të ndalojnë



Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Clinton nr 5
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

*Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.5
Prishtina 10000
Republic of Kosovo*



përfaqësuesit e ndërmarrjeve të energjisë të bëjnë shkyçjen e pajisjeve për matje ose aparaturave të tjera në lidhje me sistemin e energjisë.



2 Definicionet

2.1 Në këtë Kod përdoren këto definicione:

Termi	Shkurtesa	Definicioni
Ligji për Energjinë		Ligji nr.05/L-081 për Energjinë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i shpallur me dekretin Nr. DL-025-2016 nga Presidenti i Republikës.
Ligji për Rregullatorin e Energjisë		Ligji nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i shpallur me dekretin Nr. DL-023-2016 nga Presidenti i Republikës.
Ligji për Energjinë Elektrike		Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i shpallur me dekretin Nr. DL-026-2016 nga Presidenti i Republikës.
Ligji për Kadastër		Ligji nr. 04/-L-013 për Kadastër i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i shpallur me dekretin Nr.DL-019-2011 nga Presidenti i Republikës.
Ligji për Planifikimin Hapësinor		Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i shpallur me dekretin Nr. DL-045-2013 nga Presidenti i Republikës.
Ligji për Përdorimin e Gjuhëve		Ligji Nr. 02/L37 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i shpallur me Rregulloren e UNMIK/REG/2006/51.
Ministria	MI	Ministria përgjegjëse për fushën e energjisë.
Licenca		Dokument i lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që i mundëson bartësit të licencës të ushtrij aktivitetet në sektorin e energjisë, për të cilat nevojitet licenca në përputhje me dispozitat e ligjeve për sektorin e energjisë.
Operator i Sistemit të Shpërndarjes	OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike i licencuar nga Zyra e Rregullatorit.
Kompania Kosovare për Distribim të Energjisë Elektrike në Kosovë	KEDS	Kompani private që në bazë të licencave nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, ka ekskluzivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tërë territorin e Kosovës.
Pronari i tokës		Person fizik ose person juridik i shënuar në Regjistrin Kadastral si pronar i ngastrës kadastrale.
Plani Komunal i Zhvillimit		Plani i zhvillimit të Komunës konform kërkesave të Ligjit për Planifikim hapësinor
Zyra e Rregullatorit për Energji	ZRrE	Organ i pavarur rregullativ i themeluar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr.2004/9 dhe i cili aktualisht funksionon në bazë të ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë.



Servituti		E drejtë e OSSh-së për të instaluar pajisjet e rrjetit mbi ose në sipërfaqen e tokës që i takon pronarit. Servituti regjistrohet në Regjistrin Kadastral për t'u siguruar se cilido pronar i ardhshëm të jetë i vetëdijshëm për të.
Plani Hapësinor i Kosovës		Plani i zhvillimit të Kosovës konform Ligjit për Planifikimin Hapësinor
Plani Hapësinor për Zonat e Posaçme		Plani me atë emër i zhvilluar konform Ligjit për Planifikimin Hapësinor.
Përdoruesit e Sistemit		Personi fizik ose juridik i cili e përdor rrjetin e OSSh-së.
Plani i Zhvillimit Urbanistik		Plani me atë emër i zhvilluar konform Ligjit për Planifikimin Hapësinor.
Udhëzimi Administrativ mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë		Udhëzim Administrativ (MZHE) nr. 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë.
Udhëzimi Administrativ mbi rregullat për të drejtën e kalimit dhe të qasjes në tokën private		Udhëzimi administrativ Nr.2005/3 mbi rregullat për të drejtën e kalimit dhe të qasjes në tokën private.
Forca Madhore		Ngjarje që ndodhin e që janë jashtë ndikimit njerëzor. Janë pengesa të paevitueshme.
Regjistri Kadastral		Regjistri në të cilin janë shënuar të drejtat për pronën e paluajtshme.
Zona e Ndërtimit		Territori i caktuar për ndërtim sipas Planit detal urbanistik të Kuvendit të Komunës.
Marrëveshja për Kyçe		Kontratë e lidhur në mes OSSh-së dhe konsumatorit për lidhje në rrjetë.
Marrëveshja e servitutit		Kontratë në mes OSSh-së dhe pronarit të paluejtshmërisë në të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet reciproke.
Plani i Rregullimit Urban		Plani detal urbanistik i qytetit i aprovuar nga Kuvendi i Komunës.
Rrethanat e paparashikueshme		Gjendje e re e krijuar por e papritur si rezultat i rrethanave të paparashikueshme, e cila imponon veprime të OSSh-së jashtë standardeve të përcaktuara me këtë Kod.
Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme		Është Ligji Nr.03/L-139 për Shpronësimin E Pronës së Paluajtshme i ndryshuar/plotësuar me Ligjin nr. 03/I-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/I-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme.



2.2 Përveç kuptimeve të posaçme që kanë definicionet si më sipër, brenda këtij Kodi fjalët dhe frazat e caktuara kanë kuptimet vijuese:

- Referencat në gjininë mashkullore përfshijnë edhe referencat në gjininë femërore dhe referencat në njëjës përfshijnë edhe referencat në shumës dhe anasjelltas;
- Kodi specifikon informatat me shkrim ose konfirmimin me shkrim që duhet të jepet dhe cilindo mjet elektronik i cili mundëson që pranuesi të marrë informatën;
- Përveç rasteve ku shprehimisht thuhet ndryshe, të gjitha referencat e këtij seksioni kanë domethënie të referencave në këtë Kod;
- Cilado referencë në një ligj ose në një rregullore do të jetë referencë në atë ligj ose rregullore, ose pas zëvendësimit të atij ligji ose të asaj rregulloreje me një ligj të ri ose rregullore të re nga data e hyrjes në fuqi.

3. Kushtet e Përgjithshme

- 3.1 Punonjësit dhe kontraktuesit të cilët veprojnë në emër të OSSh-së do të njoftohen paraprakisht për përgjegjësitë e tyre para se të hynë në tokën private apo ndërtesë.
- 3.2 Përfaqësuesit e autorizuar të OSSh-së, do të vejnë kontakte me pronarin e tokës apo ndërtesave para hyrjes në këto prona. Punonjësit do të pajisen me kartelat identifikuese ndërsa kontraktuesit do të pajisen me një autorizim nga OSSh-ja me të cilat ata do t'i prezantohen pronarit të tokës apo ndërtesave.
- 3.3 Me qëllim të lehtësimit të identifikimit të përfaqësuesve të OSSh-së, automjetet të cilat shfrytëzohen për këtë rast duhet të jenë të shenjëzuara me logon e OSSh-së. OSSh-ja do të kujdeset që të ketë së paku një logo në automjet, e cila do të jetë e një madhësie që do të jetë e identifikueshme në largësi prej 100 metra. Punonjësit e OSSh-së do të bartin uniformën e cila do të ketë logon e OSSh-së. Kontraktuesit të cilët veprojnë në emër të OSSh-së janë të detyruar të theksojnë logon e tyre në uniformat e tyre.
- 3.4 Pronarët e tokës dhe ndërtesave do të trajtohen drejtë dhe me korrektësi, pa e cenuar të drejtat e tyre.
- 3.5 Pyetjet për sqarime, kërkesat e pronarëve të tokës ose ndërtesave do të trajtohen me shpejtësi nga OSSh-ja. Këtyre pronarëve duhet t'u lihet në dispozicion një numër kontaktues i telefonit dhe e-mail zyrtar.
- 3.6 Punonjësit ose kontraktuesit të cilët veprojnë në emër të OSSh-së do të hyjnë në tokë ose ndërtesa ekskluzivisht dhe vetëm për qëllime legjitime të ndërlikura me veprimtarinë e licencuar të OSSh-së përfshirë ndërtimin, mirëmbajtjen, inspektimin e pajisjeve dhe leximin e njehsorëve.
- 3.7 Punonjësit dhe kontraktuesit të cilët punojnë në emër të OSSh-së gjithnjë do të jenë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm për të minimizuar dëmet në tokë apo ndërtesa të



shkaktuar nga personat apo pajisjet. Do të kihet kujdes për mos ndotjen e ambientit me lirim të materialeve të rrezikshme dhe vajit. Nëse shfaqet një rast i ndotjes OSSh-ja do të merr masa adekuate për të minimizuar ndikimin negativ në ambient.

- 3.8 Punonjësit dhe kontraktuesit të cilët veprojnë në emër të OSSh-së do të kenë kujdes për të siguruar që toka dhe ndërtesat të kthehen po në atë gjendje sikurse para hyrjes.
- 3.9 Punonjësit dhe kontraktuesit të cilët punojnë në emër të OSSh-së duhet të kujdesen maksimalisht që kufizimet për shfrytëzim të tokës dhe ndërtesave nga pronarët të jenë sa më minimale.

4. Kushtet e veçanta

- 4.1 OSSh-ja do të publikojë njoftimin së paku pesë (5) ditë për qëllimin e tyre për të kryer ndërtim ose ndonjë punë tjetër të mirëmbajtjes në përmasa të mëdha. Në rastet e pamundësisë së publikimit të njoftimit si më lartë atëherë përfaqësuesit e OSSh-së do të kontaktojnë pronarët dhe do t'u sqarohet qëllimi i ndërmarrjes së veprimeve dhe të dëshmoj me shkrim qëllimin e kryerjes së punëve. Për punët e mëdha/voluminoze njoftimi jepet paraprakisht më së paku njëzet (20) ditë para fillimit të punëve.
- 4.2 Me ndërmarrjen e punëve të ndërtimit dhe mirëmbajtjes në tokë, punonjësit dhe kontraktuesit do të kenë kujdes që të mos shkaktojnë dëme në infrastrukturën e pronës private apo publike. Nëse me këtë rast do të shkaktohen dëmtime në infrastrukturë, atëherë OSSh-ja brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga dita e përfundimit të punëve do ta rikthejë gjendjen sikurse para fillimit të punimeve.
- 4.3 Gropat testuese, kur është e nevojshme, do të hapen vetëm pas pajtimit me pronarin e tokës. Metoda e punës do të jetë e tillë që sa më pak të reflektojë në shfrytëzim nga pronari. Këto gropa do të hapen dhe mbyllen në të njëjtën ditë. Nëse nuk mbyllen për ndonjë shkak të arsyeshem atëherë ato do të sigurohen me rrethoja. Dheu i sipërm do të veçohet anash dhe do të rivendoset kur të rimbushet gropa. Dheu i poshtëm do të ngjishet ndërsa dheu sipërfaqësor do të rivendoset mbi të.
- 4.4 Para fillimit të punëve ndërtimore përfaqësuesi i autorizuar i OSSh-së me pronarin e tokës do të diskutojë rrugët e qasjes në pronë. Me këtë rast pronarit i dorëzohet programi i punës për ndërtim. Kur arrihet pajtimi për rrugët e qasjes atëherë këto rrugë do të shënjohen me shenja të vendosura në intervale të përshtatshme kohore.
- 4.5 OSSh-ja do të presë drunj të cilët paraqesin pengesë, me kosto të veta në gjatësi normale për transportim dhe do t'i vendosë në një vend të pashfrytëzuar mundësisht afër tokës së pronarit për tu marrë nga pronari. OSSh-ja do t'i largojë të gjitha mbeturinat nga prerja e drunjëve të shkaktuara nga aktivitetet gjatë ndërtimit të linjave dhe punëve/operacioneve të mirëmbajtjes. OSSh-ja ndërmerr veprime për krasitjen e drunjëve dhe gardhiqeve kur këto paraqesin ndikim potencial në sigurinë e sistemit



të shpërndarjes. Në këto raste pronari i tokës do të njoftohet paraprakisht për hyrje në pronë të OSSh-së.

- 4.6 Në rastet e mbrojtjes së personave, kafshëve dhe të lashtave si dhe për të parandaluar hyrjen pa leje, do të vendosen pengesat e përgatitura nga OSSh-ja konform kërkesave të arsyeshme të pronarit të tokës. Gjatë fazës së përcaktimit të tipit të pengesave dhe rrethojave për tu ndërtuar do të merren parasysh karakteristikat e lokacionit, qëllimi i ndërtimit dhe kohëzgjatja e punimeve. Nëse këto rrethoja dhe pengesa mbyllin rrugë dhe shtigje dhe paraqesin vështirësi për vijueshmëri të gjallërimit të tokës nga pronari, atëherë OSSh-ja do t'i ofroj mjete transporti për kalim të personave, makinerisë dhe bagëtisë gjatë kohëzgjatjes së punëve.
- 4.7 Rrugët dhe shtigjet permanente të ndikuara nga ndërtimi do të rikthehen nga OSSh-ja në gjendjen e njëjtë sikurse para fillimit të ndërtimit ose sipas ndonjë marrëveshje të arritur.
- 4.8 Para fillimit të punimeve ndërtimore dhe shpimeve testuese pronari i tokës do të njoftojë OSSh-në, për të gjitha shërbimet nëntokësore, rrjetet e gypave, drenazheve, puseve për aq sa pronari i tokës është në dijeni.
- 4.9 Para fillimit të punimeve ndërtimore dhe shpimeve testuese në zonat e populluara OSSh-ja do të kontaktoj kompanitë për shërbime publike dhe personat tjerë relevant për të marrë informatat e rëndësishme për pozitën dhe llojin (tipin) e të gjitha shërbimeve nëntokësore.
- 4.10 OSSh-ja do të kujdeset që furnizimet me ujë dhe rrjedhja e ujërave të mos ndoten nga ndotës që dalin nga puna e tij. Gjithashtu do të ndër marr të gjitha masat e duhura për të mënjeluar pengesat për furnizim të rregullt me ujë për njerëz dhe bagëti.
- 4.11 Kur puna ndërtimore prek drenazhin, gropat septike, sistemet e ujitjes, OSSh-ja do të kujdeset që këto sisteme të jenë operative dhe të mos vij deri te ndërprerja e funksionalitetit të tyre. Pas përfundimit të punimeve këto sisteme do të rikthehen në gjendje si para fillimit të punimeve nga ana e OSSh-së.
- 4.12 Kanalet, drenazhet dhe rrjedhat e ujit të prekura do të mirëmbahen me qëllim të funksionimit efektiv gjatë tërë kohës sa zgjasin punimet në tokën e pronarit.
- 4.13 Pas përfundimit të punimeve OSSh-ja do të largoj ndërtimet e përkohshme, trasetë rrugore, tepricën e dheut, gurët dhe çfarëdo materiali tjetër që nuk i përket lokacionit por është sjellë aty si rezultat i punimeve të OSSh-së.

5 Sëmundjet e bimëve dhe shtazëve (florës dhe faunës)

- 5.1 OSSh-ja do të respektoj dispozitat ligjore, rregulloret dhe udhëzimet e ministrive kompetente të cilat orientojnë në parandalimin dhe zhdukjen e sëmundjeve të bimëve dhe shtazëve. OSSh-ja do të zbatojë masat preventive duke dezinfektuar automjetet të cilat hyjnë nëpër lokalitetet afër fermave të pronarit me rastin e ekzekutimit të punimeve ndërtimore dhe aktiviteteve të tjera që lidhen me qasjen në pronën e pronarit.



- 5.2 OSSH-ja nuk do të ngasë automjetet e veta në oborret e fermave ose nëpër lokacionet e tjera ku ka grumbullime të plehrave të shtazëve, përveç rasteve ku kjo është e paevitueshme.

6 Pëlqimet dhe Servitutet

- 6.1 Plani zhvillimor i OSSH-së do të jetë gjithmonë në harmoni me Planin Hapësinor të Kosovës, planet zhvillimore komunale, planet zhvillimore urbane, planet rregullative urbane dhe me planet hapësinore për zonat speciale. Me rastin e miratimeve apo modifikimeve të planeve të sipërme OSSH-ja do të jetë aktiv që infrastruktura/objektet e rrjetit të kenë trajtim dhe konsideratë me kompetencë.
- 6.2 OSSH-ja i nënshtrohet obligimeve ligjore për të marrë Lejet në organet kompetente për ndërtimin e çdo njësie të infrastrukturës së rrjetit në zonat e ndërtimeve të planifikuara në ndonjë nga planet nga paragrafi 6.1 i këtij seksioni dhe në zonat jashtë ndërtimeve, pra të pa përfshira në ndonjë nga planet si më sipër.

7 Krijimi dhe regjistrimi i Servitutit të Rrjetit

- 7.1 Ndërmarrja e energjisë në rast të ndërtimit të linjave, stabilimenteve të reja, ose zgjerimin e stabilimenteve ekzistuese të shpërndarjes, për të cilat nevojitet përvetësimi i servituteve, do ta njoftojë pronarin e tokës private me qëllim të arritjes së marrëveshjes.
- 7.2 Ndërmarrja e energjisë duhet ta njoftojë pronarin lidhur me stabilimentin, afatin kohor të nevojshëm për shfrytëzim, ndryshimin e destinimit të tokës, planin e rregullimit pas përfundimit të servitutit dhe vlerën e propozuar të kompensimit sipas dispozitave përkatëse të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.
- 7.3 Marrëveshja e servitutit do të lidhet për linjat ajrore dhe kablovike për tensionet 35 kV, 20 kV, 10 kV, 6kV dhe 0,4 kV, që kalojnë mbi apo nëpër tokën e pronarit përveç rrugëve publike apo pronës tjetër publike (urave, trotuareve dhe ndërtesave).
- 7.4 Në rast se të pamundësisë së arritjes së marrëveshjes mes OSSH-së dhe pronarit të tokës për krijimin dhe zgjerimin e servituteve në afatin brenda tridhjetë (30) ditësh nga dërgimi i propozimit me shkrim nga OSSH-ja, OSSH-ja do të kërkon nga Zyra e Rregullatorit për Energji që ta lëshojë një opinion lidhur me detyrimet e ndërmarrjes së energjisë.
- 7.5 OSSH-ja në afatin optimal, do të paraqesë kërkesë me shkrim për t'i regjistruar këto servitute në Regjistrin Kadastral të Komunës. Qëllimi i këtij regjistrimi është që organi komunal kompetent t'i identifikoj dhe përfshij zonat e sigurisë në planet hapësinore për zonat speciale, në planet zhvillimore komunale dhe në planet rregullative urbane.



8 Kushtet e marrëveshjes për servitut

- 8.1 Pagesa do t'i jepet pronarit legjitim të tokës. Kjo pagesë do të mbuloj barrën e servitutit dhe dëmet që janë shkaktuar me rastin e ekzekutimit të punimeve të llogaritur në pajtim me Ligjin për Energjinë dhe Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.
- 8.2 Pronari i tokës do të merr obligimin që me rastin e menaxhimit të veprimeve në tokë nuk do të shkaktoj asnjë dëm në pajisjet e vendosura nga OSSh-ja. Pronari i tokës obligohet që të kompensojë shpenzimet e arsyeshme të OSSh-së nëse shkakton dëme në zonën e sigurisë ose mundëson të tjerët të shkaktojnë dëme në atë zonë. Kompensimi i dëmit do bëhet me marrëveshje mes palëve. Në rast të kontestimit, do vendoset nga Gjykata kompetente.
- 8.3 OSSh-ja do të ketë të drejtën e qasjes në pajisjet/asetet e veta që janë pjesë përbërëse e rrjetit të vet, në pajtim me këtë Kod;
- 8.4 OSSh-ja do të ketë të drejtën e ndërmarrjes së krasitjes së drunjtëve dhe shkurreve në afërsi të largpërçuesve për aq sa kërkojnë normat teknike të sigurisë së sistemit të shpërndarjes;
- 8.5 Në rastet e ripërtëritjes së rrjetit ku strukturat ose kabllot duhet ndërruar sipas pozicioneve përafërsisht të njëjtë, marrëveshjet e servituteve nuk do të lidhen sepse ato janë lidhur në kohën e kryerjes së punimeve të para. Por, kur strukturat dhe kabllot e reja vendosen në lokacione të reja atëherë ndërtimi dhe shtrirja e këtyre aseteve kushtëzohet me lidhjen e një marrëveshje të re të servitutit me pronarin legjitim të tokës.
- 8.6 OSSh-ja do të kërkojë Leje apo/Pëlqim nga organi komunal kur operatori ka për qëllim të shtrij kabllot në rrugët publike apo në shtigjet që janë pronë publike. Për çdo rast OSSh-ja do të konsultohet me organin komunal para fillimit të punimeve dhe do të respektoj cilindo kusht të specifikuar nga organi komunal derisa ekzekutohen këto punime, (kufizimi i punimeve në orar të caktuar për shkak të trafikut automobilistik etj.).
- 8.7 Marrëveshja e servitutit lidhet nga zyrtari i autorizuar i OSSh-së. Për negociata fillestare me pronarin legjitim të tokës OSSh-ja mund të autorizon kontraktuesin e vet si pjesë e procesit të para ndërtimit për pozitën e shtyllave ose kabllave.
- 8.8 Neni 7 nuk do t'i kufizojë obligimet e përgjithshme të OSSh-së ndaj pronarëve kur t'i qaset pronës së tyre (siç është e theksuar në nenin 3 dhe 4 të këtij Kodi). Për më tej, OSSh-ja do të bëjë përpjekje, kurdo që është e përshtatshme, të arrijë marrëveshje të servitutit me pronarët legjitim, para fillimit të zbatimit të projektit të rrjetit.

9 Rrjeti i ndërtuar në periudhën kohore 1990 - qershor 1999

- 9.1 Pjesët e rrjetit të ndërtuar gjatë periudhës 1990 deri më 10 qershor 1999, që kanë mbështetjen në marrëveshjet e servituteve me pronarët e tokës dhe se nën kushtet e Rregullores së UNMIK/REG/2000/59 për ligjin e aplikueshëm në Kosovë, këto



marrëveshje vazhdojnë të kenë efekte juridike.

- 9.2. Marrëveshjet e servituteve të lidhura me pronarët e tokave për periudhën e specifikuar konsiderohen se përmbajnë dispozitat e nenit 8 që përcakton parimet e Kushteve të marrëveshjes.
- 9.3 OSSH-ja do të veproj në harmoni me kushtet e marrëveshjes së servitutit, me këtë Kod dhe me obligimet tjera ligjore. Aty ku paraqitet nevoja, OSSH-ja do të zëvendësoj asetet ekzistuese me asetet ekuivalente në pajtim me marrëveshjen aktuale.

10 Qasja në lokacionet në pronësi ose të operuara nga pronari

- 10.1 Për të garantuar operim të sigurt të rrjetit publik të energjisë elektrike, OSSH-ja kërkon qasje 24 orë në të gjitha pjesët e sistemit të rrjetit. Kjo ka të bëjë me pajisjet e rrjetit të sistemit shpërndarës të cilat ndodhen brenda lokacioneve, në pronësi ose të operuara nga pronari.
- 10.2 Pronarët duhet t'u lejojnë përfaqësuesve të OSSH-së të kenë qasje 24 orë në stabilimente/pajisje të shpërndarjes dhe stabilimente që i takojnë pronarit, ku operimi i tyre është i nevojshëm për një qëllim të caktuar.

11 Qasja në pjesët tjera të instalimeve të përdoruesve të sistemit

- 11.1 OSSH-ja mund të kërkoj qasje në të gjitha pjesët e operuara nga Përdoruesi i Sistemit në kohë të përshtatshme, por nuk kufizohet në situata kur OSSH-ja është duke hetuar devijimet nga Kodi i Shpërndarjes.
- 11.2 OSSH-ja do të bëjë kontakte paraprake me Përdoruesin e Sistemit që qasja të jetë e sigurt kur është e nevojshme për operimin e sistemit shpërndarës. Kur OSSH-ja është duke hetuar një devijim të sistemit të shpërndarjes i shkaktuar nga operimi i Përdoruesit të Sistemit dhe qasja e plotë nuk është e mundur, atëherë OSSH-ja mund të shkyçë instalimin e Përdoruesit të Sistemit nga rrjeti i shpërndarjes derisa të mundësohet qasja e plotë.

12 Përdorimi i gjuhëve

- 12.1 OSSH-ja do të lidhë marrëveshje me shkrim me palët në cilëndo gjuhë e cila e ka statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në komunat e Republikës së Kosovës, konform Nenit 2 dhe 30 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Nr.02/L-37. Nëse pala nuk bënë zgjedhjen e gjuhës atëherë OSSH-ja përcakton gjuhën e cila do të përdoret për komunikim.
- 12.2 Karta e identifikimit dhe shkresa/vërtetimi do të përpilohen konform Nenit 2 dhe Nenit 30 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Nr.02/L-37.
- 12.3 Lëshimi i dokumenteve të tjera nga OSSH-ja që kanë për qëllim përmbushjen e kërkesave të këtij Kodi do të bëhet në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës konform Nenit 2 dhe Nenit 30 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Nr.02/L-37.



Zgjedhja mund të bëhet nga pala por kur mungon një zgjedhje e tillë atëherë OSSh-ja do të përcakton gjuhën e cila do të përdoret në komunikim mes palëve. OSSh-ja nuk mund të garantoj që përfaqësuesit e tij, të cilët kërkojnë qasje në rrjetin e operuar nga OSSh-ja do të jenë në gjendje të komunikojnë në gjuhën e caktuar. Në ato situata, OSSh-ja do të ndërmer veprime të përshtatshme për të siguruar që arsyeja për vizitën mund të shpjegohet në ndonjërin nga gjuhët zyrtare sipas nenit 30 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve qoftë gojarisht apo duke ju referuar kartelave apo në raste të skajshme duke ofruar një numër të telefonit për të ndihmuar komunikimin. Vështirësitë për komunikim nuk do të trajtohen nga OSSh-ja si arsye për të penguar përfaqësuesit e tij në kryerjen e detyrave legjitime.

13 Procedura e kontesteve

Kontestet që mund të shfaqen gjatë zbatimit të rregullave/dispozitave të këtij Kodi do të zgjidhen me marrëveshje mes palëve, në të kundërtën do të zgjidhet nga gjykatat kompetente në Republikën e Kosovës.

14 Kompensimi i dëmeve

Ndërmarrja e energjisë i kompenson pronarët ose shfrytëzuesit e pronës për çfarëdo dëmi që mund të shkaktohet gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre që mund të rezultojë në kufizimin e shfrytëzimit të pronës ose zvogëlimin të vlerës së saj. Në rast të kontestit, do zgjidhet nga Gjykatat kompetente në Kosovë.

15 Mbrojtja e servituteve

Nëse servitutet, si e drejtë e OSSh-së mbi sendet e huaja, vihen në dyshim apo në ndonjë formë rrezikohen nga kushdo qoftë, pronari i tokës apo një palë e tretë, atëherë OSSh-ja do të kërkojë mbrojtje juridike nga Gjykata në territorin e së cilës është regjistruar servituti.

16 Rrethanat e paparashikuara

- 16.1 Nëse paraqiten rrethana të cilat nuk mund të parashikohen, OSSh-ja menjëherë i fillon konsultimet me të gjitha palët e ndikuara nga këto rrethana. Qëllimi i këtyre konsultimeve është arritja e marrëveshjes për veprimet që duhet të ndërmerren. Nëse për këtë kohë nuk mund të gjinden marrëveshje me palët e ndikuara nga këto rrethana, OSSh-ja duke vepruar si operator i përgjegjshëm përcakton se cilat veprime duhet të ndërmerren. Për këto veprime të cilat OSSh-ja i ndërmer, duhet që sa më shpejt që është e mundur të njoftojë palët, Ministrinë përkatëse, autoritetet komunale dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji për vendimin që ka marrë me një arsyetim të qëndrueshëm.
- 16.2 OSSh-ja kurdoherë që merr një vendim në këto rrethana, duhet të merr parasysh edhe opinionet e palëve për aktivitetet që duhet të ndërmerren nga operatori i sistemit.
- 16.3 Pas përfundimit të gjendjes të cilën e kanë shkaktuar rrethanat e paparashikueshme, OSSh-ja do të kujdeset që këto rrethana t'i trajtojë si jo të paparashikueshme por të



përfillë dhe zbatojë procedurat e ndryshimit dhe plotësimit të këtij Kodi. Gjithashtu edhe vendimet e miratuara për aktivitetet e tij nën rrethanat e paparashikueshme t'i inkorporojë si veprime standarde në këtë Kod në të njëjtën procedurë.

17 Ndikimi i forcës madhore

- 17.1 Me rastin e veprimit të forcës madhore OSSh-ja mund të mos jetë në gjendje për t'i kryer obligimet e veta të parashikuara me këtë Kod. Me këtë rast OSSh-ja do t'i njoftojë të gjitha palët e përfshira (Ministritë përkatëse, autoritetet komunale etj.) si dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji, duke dhënë detaje për pamundësinë e përmbushjes së obligimeve. OSSh-ja gjithashtu duhet të paraqet konstatimin e vet se pse beson se ky dështim është si pasojë e veprimit të forcës madhore dhe sa do të zgjas kjo kohëzgjatje e fuqisë madhore. Gjatë kohëzgjatjes së forcës madhore obligimet e palës duhet të jenë minimale të nevojshme për rrethanat e krijuara nga veprimi i forcës madhore.
- 17.2 Nëse pala mendon se deklarimi i forcës madhore nga OSSh-ja është joreal, ajo ka të drejtë që këtë çështje ta kontestoj pranë gjykatës kompetente.

18 Ndryshimi

Amendamentet ose ndryshimet në këtë Kod mund të iniciohen nga OSSh-ja dhe nga ZRrE-ja, dhe do të aprovohen me të njëjtën procedurë sikurse edhe me rastin e miratimit të tij.

19 Hyrja në fuqi

Ky Kod aprovohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 16.11.2022, dhe hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit në Ueb faqen elektronike të OSSh-së.